



Pranuar / Dorezuar Primihera/Prodato Received/Delivry	02.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednitca Org./Unit	Nr. Pror. Br. Pror. Prot. No	Shtypje Printog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHKIK	1117/2022		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.01/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.01/2022 të datës 05.01.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike „kundër vendimit të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 23.12.2022”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 01.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.01/2022 e datës 05.01.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër të protokollit 1527 i datës 23.12.2021 i Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. Obligohet Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Personelit i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që ti ndërmerr të gjitha veprimet ligjore në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për zbatim të këtij vendimi, që të vazhdohet me procedurën e rekrutimit për vendin e punës “Zyrtar i Personelit 2” në Burgun e Sigurisë së lartë”.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi me datë 05.01.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 03/2022,1/10,në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit 1527 të datës 23.12.2021 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, kundër anulimit të procesit të rekrutimit për vendin e punës Zyrtar i Personelit 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.01.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa me datë 27.01.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankese së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Më datë 14/02/2022 sipas vendimit VK.nr.14/2022,Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ka vazhduar afatin e vendosjes së kësaj ankese edhe për dhjetë(10)ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 05.01.2022 me numër protokollit 03/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rezultatet e vlerësimit Aplikacioni i datës 12.11.2021; Njoftim i datës 03.12.2021; Vendimi i datës 23.12.2021 me numër 1527 për anulimin e procedurës së rekrutimit RN00007757 Zyrtar i Personelit i nxjerrë nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK; Vendimi i datës 28.12.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SHKK; E-mail zyrtar i datës 05.01.2022; Formulari i regjistrimit të ankesës; Lista e aplikantëve për pozitën Zyrtar i Personelit 2; Njoftimi i datës 03.12.2021; Njoftimi i datës 24.11.2021; Kërkesë për fillimin e rekrutimit i datës 08.10.2021; Kopja e konkursit prej datës 11.11.2021 deri me datën 18.11.2021; Vendimi i datës 07.10.2021 për hartimin e rregullores për Organizimin e Brendshëm; Aplikacioni për datës 11.11.2021; Diploma master e datës 01.11.2019 me nr. 2041 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diplomë e datës 26.03.2015 me nr.5059 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Çertifikatë e datës 15.11.2019; Çertifikatë e muajit janar 2021; Çertifikatë e muajit tetor 2019; Çertifikatë e muajit nëntor2020; Vërtetim i muajit korrik 2020; Vërtetim i datës 06.10.2021; Rekomandim i muajit korrik 2020; Kopja e letërnjoftimit ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 30.11.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 05.02.2020; Aplikacioni i datës 12.11.2021 për

Vërtetim mbi marrëdhënjen e punës i datës 08.01.2013; Çertifikatë e datës 20.05.2011; Çertifikatë e datës 26.10.2021; Çertifikatë e datës 25.10.2013; Diploma e datës 05.05.2005; Vërtetim i datës 01.10.2014; Diploma e datës 09.03.2020 me nr.10897 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 15.07.2020; Çertifikatë e datës 25.10.2013; Kontratë pune për kohë të pacaktuare datës 15.07.2020; Referencë e datës 12.11.2021; Kopja e letërnjoftimit ; Vlerësimi i rezultateve në punë i datës 28.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 18.12.2019; Vërtetim i datës 16.11.2021; Aplikacioni i datës 18.11.2021 për

Diploma Master e datës 07.06.2021 e lëshuar nga Kolegji AAB; Diplomë e datës 30.12.2008 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; Diploma e datës 06.06.2005; Çertifikatë e muajit qershor 2021; Çertifikatë e datës 21.03.2017; Çertifikatë e vitit 2015-2017; Çertifikatë e datës 19.11.2013; Çertifikatë e datës 23.10.2009; Çertifikatë e datës 20.10.2009; Çertifikatë e datës 06.11.2007; Çertifikatë e datës 28.02.2007; Çertifikatë e datës 10.03.2009; Kontratë pune me kohë të caktuar prej dt.01.09.2008 deri më datën 31.12.2010; Kontratë mbi punën e datës 06.08.2010; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 01.12.2010; Akt emërimi i datës 03.01.2013; Akt emërimi i datës 04.01.2012; Letër referuese e punësimit e datës 15.08.2010; Vendim për pushim të lehonisë i datës 10.07.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 27.01.2020; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 11.06.2020; Çertifikatë e datës 08.08.2012 me nr.20251 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; Diploma e datës 13.06.2007; Aplikacioni i datës 18.11.2021 për Akt emërimi i datës 03.01.2012; Vërtetim i datës 15.11.2021; Kopja e letërnjoftimit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 24.12.2020; Vërtetim i datës 16.11.2021; Aplikacioni i datës 12.11.2021 për i cili nuk plotëson kushtet për lëvizje brenda kategorisë në këtë procedurë sepse nuk e ka statusin e shërbyesve civil-(Vendim i datës 24.11.2021 i nxjerrë nga Menaxheri i Personelit); Aplikacioni i datës 18.11.2021 për Diplomë e datës 24.07.2013 me nr.2096 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Çertifikatë e datës 14.10.2021; Çertifikatë e muajit shtator 2021; Çertifikatë e datës 17.09.2021; Çertifikatë e datës 28.04.2021; Çertifikatë e datës 25.04.2021; Çertifikatë e datës 28.10.2019; Çertifikatë e datës 09.03.2020; Çertifikatë e datës 23.10.2018; Çertifikatë e datës 08.06.2017; Çertifikatë e datës 24.03.2017; Çertifikatë e datës 09.03.2020; Çertifikatë e datës 03.07.2017; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 01.12.2010; Rekomandim për përtëritjen e kontratës 03.09.2013; Kopja e letërnjoftimit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Vërtetim i datës 16.11.2021; Vendim i datës 23.08.2018; Vendim i datës 14.02.2019; Vendim i datës 28.07.2020; Çertifikatë e notave 20.09.2011; Aplikacioni i datës 18.11.2021 për Diplomë e datës 26.02.2018 nr.90/18; Vërtetim i datës 30.07.2019; Çertifikatë e datës 05.03.2021; Kontratë pune për kohë të caktuar i datës 19.02.2019; Kontratë pune për kohë të caktuar i datës 19.08.2019; Kontratë pune për kohë të caktuar i datës 11.08.2019; Kontratë pune për kohë të caktuar i datës 11.06.2020; Letër referenc i datës 15.02.2019; kopja e letërnjoftimit Kontratë pune për kohë të caktuar i datës 19.02.2019; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020; Vërtetim i datës 16.11.2021; Vendimi i datës 14.10.2022 VK.nr.14/2022 për vazhdimin e afatit për vendosje për 10(dhjetë)ditë pune të ankesës me numër A.nr.01/2022 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 27.01.2022 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar sepse:

Sipas shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Zëvendësuesi Drejtorit të Përgjithshëm me datë 08.10.2021 ka nënshkruar kërkesën për aprovimin e titullit të vendit të punës Zyrtar i Personelit 2, më datë 27/10/2021 është njoftuar nga institucioni për shpallje të konkursit, ndërsa me datë 11.11.2021 ka shpallur konkursin për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RPC00007757 për vendin e punës Zyrtar i Personelit 2 në Shërbimin Korrektues të Kosovës/Burgu i Sigurisë së Lartë, i cili konkurs ka qenë i hapur deri më datë 18.11.2021 e që ky veprim ka qenë në pajtim me dispozitat e nenit 42 paragrafit 2 të Rregullores (QRK)

Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili ka përcaktuar se: *Fillimi i një procedura për lëvizjen brenda kategorisë, është i mundur vetëm pas miratimit nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit.*

Sipas konkursit me numër reference RN00007757 i shpallur me datë 27.10.2021, për vendin e punës Zyrtar i Personelit 2 në Shërbimin Korrektues të Kosovës/Burgu i Sigurisë së Lartë, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, në drejtimin : Drejtësi/Ekonomik (pavarësisht nga specialiteti, Administrata Publike;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: dy vite përvojë pune.*

Ankuesi, për këtë pozitë të punës, ka aplikuar me datë 12.11.2021 me numër aplikacioni RAN00007757, ndërsa me datë 24.11.2021 është publikuar njoftimi se shtatë (7) kandidatët që kanë aplikuar në procedurën e rekrutimit 6(gjashtë) i kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për lëvizje brenda kategorisë, ndërsa 1(një) kandidatë nuk i ka plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për lëvizje brenda kategorisë sepse nuk e ka pas statusin e shërbyesve civil, veprim ky në pajtim me dispozitat e nenit 45 paragrafit 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *Kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë renditjes në një listë të shkurtër në rendin alfabetik. Lista e shkurtër shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve.*

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datë 06.12.2021 ka nxjerr Vendimin me numër të protokollit 1336 me të cilin ka emëruar Komisionin Vlerësues për zhvillimin e procedurës së rekrutimit, gjegjësisht lëvizjes brenda kategorisë për pozitën e punës Zyrtar i Personelit 2 (një pozitë) në Burgun e Sigurisë së Lartë, në pajtim me dispozitat e nenit 46 paragrafit 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *Çdo institucion themelon Komisionin e vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë (në tekstin e mëtejme "KVLBK").*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu duke iu referuar shkresave të lëndës të dorëzuara nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar se ankuesi i ka kryer me sukses të gjitha fazat prej verifikimit paraprak e deri te intervistimi me gojë, sipas sistemit elektronik kodi i aplikimit të ankuesit ka qenë RAN0001352, i aprovuar dhe i suksesshëm i përfunduar në të gjitha fazat.

Me datë 23.12.2021, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes Vendimit me numër të referencës 1527 ka anuluar procedurën për lëvizje në kategori me numër reference RN00007757 për pozitën e punës Zyrtar i Personelit 2, në Burgun e Sigurisë së Lartë, me arsyetimin se institucioni është në fazën e hartimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm. Kundër vendimit për anulimin e kësaj procedure, me datë 05.01.2022 ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor se Vendimi me numër të referencës 1527 për anulimin e procedurës për lëvizje në kategori, për pozitën e punës Zyrtar i Personelit 2 me numër reference RN00007757 është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të

Republikës së Kosovës, dhe i njëjti ka kërkuar që të vazhdohet me proces të rekrutimit për shpalljen e kandidatit fitues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, analizoi provat e administruara dhe rrjedhimisht duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstatoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për anulimin e procedurës për lëvizje në kategori, sepse sipas shkresave të lëndës është konstatuar se procedura e lëvizjes në kategori për vendin e punës *Zyrtar i Personelit 2*, në Burgun e Sigurisë së Lartë është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ndërsa Vendimi me numër të protokollit 1527 i datës 23.12.2021 përmes të cilit është anuluar procedura e rekrutimit me arsyetimin se organi i punësimit është në proces të hartimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, nuk ka mbështetje ligjore sepse sipas shkresave të lëndës rezulton se Grupi Punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është themeluar me Vendimin me numër të protokollit 1145 të datës 07.10.2021 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa një ditë më vonë, gjegjësisht me datë 08.10.2021 i njëjti organ ka aprovuar kërkesën për fillimin e procedurës për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Zyrtar i Personelit 2*. Andaj Kolegji vlerëson se veprimet juridike të ndërmarra nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm nuk janë në harmoni me njëra tjetrën, sepse i njëjti ka qenë në dijeni lidhur me procesin e hartimit të rregullores për Organizimin e Brendshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe përkundër kësaj ka aprovuar kërkesën për fillimin e procedurës së rekrutimit dhe si rezultat i këtij veprimi është bërë hapja e konkursit për lëvizje brenda kategorisë, me datë 11.11.2021. Për më tepër, organi i punësimit në arsyetimin e Vendimit me numër të protokollit 1527 të datës 23.12.2021, vetëm ka specifikuar se: *SHKK-ka publikuar konkurset e brendshme për lëvizje në detyrë për pozitë e lartçekura, meqenëse jemi në fazën e hartimit të rregullores për organizimin e brendshëm deri në miratimin e kësaj rregullore, konkurset e shpallura anulohen*, mirëpo nuk ka dhënë ndonjë arsyetim bindës lidhur me atë se me miratimin e kësaj rregullore do të ketë ndryshime lidhur me statusin e pozitës përkatëse të shpallura për lëvizje në kategori, ku si rrjedhojë ndryshimet e tilla do të ndikojnë edhe në këtë proces.

Andaj, bazuar në konstatimin si më lartë, dhe duke marr parasysh se veprimet procedurale lidhur me konkursin e shpallur me datë 11.11.2021, deri në ditën e anulimit, janë zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë vendosi për anulimin e Vendimit me numër të protokollit 1527 të datës 23.12.2021. Rrjedhimisht obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që t'i ndërmerret të gjitha veprimet e duhura procedurale për vazhdimin e procedurës së rekrutimit të shpallur me datë 11.11.2021, për vendin e punës *Zyrtar i Personelit 2*, me numër reference RN00007757, në pajtim me nenin 49 paragrafin 2 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha me lartë konform dispozitave të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.01/2022, datë 01.03.2022

Sabile AVDYLI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMShCK-së